



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALËSI E MADHE
SEKTORI I AUDITIT TË BRËNDSHEM

Nr. 992 Prot.

Koplik, me:06/02/2018

Lenda: Raporti Vjetor i Sektorit Auditimit të Brendshëm për vitin 2017.

Drejtuar: MINISTRISË SE FINANCAVE
(Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit Brendshëm)

T I R A N E.

I. Ky raport auditimi pasqyron rezultatet e arritura nga sektori i auditimit të brendshëm të krahasuar me objektivat dhe planifikimin vjetor, duke ndihmuar drejtorinë, sektoret si dhe njësitë vartëse pranë bashkisë në realizimin e objektivave, rritjen e efikasitetit në përdorimin e fondeve publike. Drejtoritë, sektoret dhe njësitë vartëse të audituara kanë reaguar pozitivisht, duke iu përgjigjur rekomandimeve të lëna nga auditimi i brendshëm, të cilat i kanë shërbyer edhe përmirësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Ky raport paraqet shkallën e përmbushjes së programit të auditimit të brendshëm, menaxhimin e burimeve, treguesit e performancës, si dhe shkallën e pajtueshmërisë me standardet profesionale.

Për vitin 2017 janë programuar të realizohen 8 auditime, dhe 2 zbatime rekomandimesh ku në faktë janë realizuar 6 auditime dhe 2 zbatime rekomandimesh.

II. Baza ligjore e punës auditimit brendshëm është ligji nr. 114/2015 “Për auditin e brendshëm” në sektorin publik, ligji nr 10296 dt 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen vendore”, Manuali i Auditimit të brendshëm.

Puna e sektorit të auditimit është bazuar në tematikën e hartuar dhe të miratuar nga titullari i institucionit në zbatim të ligjit të auditimit nr 114/2015 .

III. Misioni, qëllimi dhe përgjegjësitë janë të percaktuara në rregulloren e Administratës të miratuar me VKB nr 1739 dt 04.07.2016 ku jepet dhe përshkrimi i pozicionit të punës për të mos patur mbivendosje detyrash.

Sektori i auditimit brendshëm është në vartësi të Kjetarit Bashkisë.

Përbëhet vetëm nga tre punonjës .(1 Përgjegjës dhe 2 Specialiste të auditimit të brendshëm).

1- PROGRAMI I ANGAZHIMIT TË AUDITIMIT PER VLERESIMIN E AKTIVITETIT TE POLICISE BASHKIAKE BASHKIA MALESI E MADHE

Ne zbatim te planit te auditimeve per vitin 2017 i miratuar nga Kryetari i Bashkise Malesi e Madhe Tonin Marinaj me nr. 2823 prot , date 10/10/2016 Njesia e Auditimit te Brendshëm do të angazhohet në një mision auditimi .

Objekti i Auditimit : Policia Bashkiake

Qellimi i Auditimit : verifikimi i realizimit te detyrave funksionale ne perputhje me ligjin dhe Rregulloren e Brendshme te Bashkise .

Te ndihmoje ne realizimin e objektivave te veprimtarise duke permirsuar sistemet e kontrollit .

Lloji i Auditimit : perputhshmerise dhe performances

Metoda e Auditimit : i plote

Baza ligjore .

- Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”
- Ligji nr. 8224 date 15/05/1997 ‘Per policine bashkiake’ i ndryshuar
- Ligji nr 10296 date 8.7.2010 ‘per menaxhimin financiar dhe kontrollin ‘me ndryshime
- Si dhe akte te tjera nenligjore ne zbatim te ketyre ligjeve
- Si dhe mbeshtetur ne Rregulloren e Brendshme te Bashkise Malesi e Madhe .

Spektori I Policise Bashkiake eshte pjese e struktures se Bashkise Malesi e Madhe Krye Inspektor eshte emeruar z. Rasim Smakaj .

Policia Bashkiake ka kete strukture ne fund te vitit 2016.

1-Rasim Smakaj kryeinspektor 2-Brahim Sykaj 3-Gezim Kurtaj 4-Sander Elezaj 5-Sabah Mataj 6-Agim delishaj 7-Agron Bajrakurtaj .

Ne perfundim te raport-kontrollit grupi I kontrollit arrin në konkluzionet.

Nga ana e kryeinspektorit të Policisë Bashkiake z.Rasim Smakaj dhe stafit te tij nuk është punuar si duhet në permbushjen e detyrave që janë caktuar në ligjin për Policinë Bashkiake nr 8224 date 15.05.1997 I ndryshuar si dhe nuk janë përmbushur si duhet detyrat që janë të percaktuar në rregulloren e Bashkisë .

1. Informacioni I dhënë ndaj Kryetarit të Bashkisë për punen e bërë është formal, I pa mbështetur në dokumente ligjore .

2 Bashkepunimi I bërë me sektorët të tjere është pa fryte,nuk ka ndjekje ligjore , akt-konstatimet e firmosura nuk kanë asnjë mbështetje ligjore . Shprehjet e përdorura u be bllokimi I aktivitetit nuk jane te shoqeruar me urdher bllokimi , me shirita dhe nuk jane siç kerkon ligji.

3.Mbajtja e proces-verbal I konstatimit të shkeljes për gjobat e vendosura nga ana e inspektore të policisë dhe kryeinspektorit kane mangesi ,si ne shkrimin e tyre , në përpilimin e shkeljes , nuk vendoset adresa , nuk shkruhet emri I plotë i punonjësit të policisë mjaftohen vetem me inicialet e emrit ne disa raste nuk vendoset emri.

4. Per gjobat e vendosura dhe te papaguara nuk janë marre masat ligjore për vjeljen e tyre kjo per 27 raste me vlere 27000 leke .

5. Lidhur me ndjekjen e ankesave të qytetareve roli I policisë është kthyer si një organizem pajtimi , nuk trajtohen çështjet në frymen e ligjit , dhe nuk merren masa administrative për shkeljet e konstatuara , si per lidhje te tubacioneve te ujit pa patur pa leje nga individe te ndryshem, ndërsa rastet e tjera trajtohen shkarazi pa seriozitetin e ligjit.

6.Nuk është i impenjuar në detyrat e ngarkuara nga zv/kryetari I bashkisë për të bashkëpunuar lidhur me detyrat e lena nga KLSH. Siç është trajtuar me sipër.

7. Planet mujore të punës janë formale pa tematika të veçanta .Kjo vjen se nuk njihet realiteti dhe situata nga analiza e tyre janë një copy-paste për çdo muaj.

8.Me dokumentacionin shtesë nuk është sjellë libri I shërbimit .

Për përmisimin e punës dhe përmbushjen e detyrave qe ka Policia Bashkiake I jepen keto **Rekomandime ;**

Të eliminohen të gjitha të metat e konstatuara dhe të trajtuara më sipër si në perpilimin e informacionit per Kryetarin e Bashkise , në bashkëpunimin në mes sektoreve, në perpilimin e proces-verbalit te konstatimit në përputhje me të gjitha rubrikat që ka,dhe në trajtimin sipas ligjit të rasteve të ankimit që bejnë qytetarët . Afati gjatë gjithë vitit.

Të merren masa për arktimin e gjobave si dhe të llogariten kamate- vonesat për mos pagimin në afatet ligjore siç është përcaktuar në proces-verbal I konstatimit të shkeljes deri me 30/06/2017 .

Per masat administrative qe do te merren me shkresen shoqeruese te raportit-kontrollit - perfundimtare – do ti behet propozimi Kryetarit të Bashkisë .

Ky raport-kontrolli-perfundimtar u perpilua në tre kopje një kopje I dërgohet me protokoll Kryeinspektorit të Policisë Bashkiake z. Rasim Smakaj.

2- PROGRAMI I ANGAZHIMIT TË AUDITIMIT PER VLERESIMIN E AKTIVITETIT TE SEKTORIT TE EMERGJENSIVE CIVILE

Në zbatim të planit të auditimeve për vitin 2017 i miratuar nga Kryetari i Bashkisë Malesi e Madhe Tonin Marinaj me nr. 2823 prot , datë 10/10/2016 Njësia e Auditimit të Brendshëm do të angazhohet në një mision auditimi .

Objekti i Auditimit : Sektori i Emergjensave Civile

Qëllimi i Auditimit : verifikimi i realizimit të detyrave funksionale në përputhje me ligjin dhe Rregulloren e Brendshme të Bashkisë .

Të ndihmoje në realizimin e objektivave të veprimtarisë duke përmirsuar sistemet e kontrollit .

Lloji i Auditimit : financiar dhe performancës

Metoda e Auditimit : i plote

Baza ligjore .

- Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”
- Ligji nr.8756 date 26.03.2001 ‘per emergjensat civile’ i ndryshuar
- Ligji nr. 8766 date 05/04/2001 ‘Per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimi ’ i ndryshuar
- VKM Nr.835 date 03.12. 2004 ‘Per Planin Kombetar te Emergjensave Civile‘me ndryshime.

- VKM Nr. 655 date 18.12.2000 ‘per ngritjen dhe funksionimin e strukturave te sistemit Kombetar te Planifikimit dhe te Perballimit te Emergjensave civile’
- VKM Nr.664 date 18.12.2000 ‘per kriteret dhe procedurat e shpalljes se gjendjes se E.Civile ‘
- Si dhe akte te tjera nenligjore ne zbatim te ketyre ligjeve

Si dhe mbeshtetur ne Rregulloren e Brendshme te Bashkise Malesi e Madhe

Spektori I Emergjensave Civile eshte pjese e struktures se Bashkise Malësi e Madhe me Përgjeggjes sektori z.Qerim Hysa me inspektor z.Jakup Mehmeti dhe z.Ajet Gjekaj .

Në përfundim të raportit të kontrollit arrihet në konkluzion se ka një mangësi të gjithanshme të dokumentacionit justifikues që provohet se detyrat e vendosura në planin e punës janë realizuar . Siç e kemi trajtuar edhe më sipër referuar planeve - mujore të punës të hartuar , nga verifikimi analitik të detyrave që janë vendosur mungon dokumentacioni që tregon se keto detyra janë realizuar , në dokumentat e paraqitura kemi mungesë të akteve të inspektimit , apo të kontrollit që tregojne se keto detyra të jenë të realizuara , si për ato që janë për tu realizuar në zyre , dhe për ato që jane për tu realizuar në terren.Kështu ky plan mbetet vetem në leter.

Rekomandimet .Përgjegjësi i emergjencave civile në Bashkinë Malësi e Madhe z. Qerim Hysa për çdo detyre që planifikon dhe miraton te Kryetari i Bashkisë dhe është e shënuar në planin mujor të mbaj dokumentacionin e duhur siç jane aktet e inpektimit , aktet e kontrollit, apo çdo dokument qe verteton që detyra e caktuar në planin mujor janë realizuar këto dokumenta të dorzohen në protokollin e bashkisë .

3- PROGRAMI I ANGAZHIMIT TË AUDITIMIT PER VLERESIMIN E AKTIVITETIT TE NJESISE ADMINISTRATIVE KELMEND.

Në zbatim të planit të auditimeve për vitin 2017 i miratuar nga Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe Tonin Marinaj me nr. 2823 prot , datë 10/10/2016 Njësia e Auditimit të Brendshëm do të angazhohet në një mision auditimi .

Objekti i Auditimit : Njesia Administrative Kelmend

Qellimi i Auditimit : Verifikimi i realizimit të detyrave funksionale në përputhje me ligjin dhe Rregulloren e Brendshme të Bashkisë .

Të ndihmoje në realizimin e objektivave të veprimtarisë duke përmirsuar sistemet e kontrollit .

Lloji i Auditimit : financiar dhe performances

Metoda e Auditimit : i plote

Baza ligjore .

- Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”
- Ligji nr.9632 date 30/10/2006 ‘Per Sistemin e Taksave Vendore’i ndryshuar.
- Ligji nr. 10296 date 08/07./2010’’Per menaxhimin financiar dhe kontrollin’’ i ndryshuar

- Si dhe akte te tjera nenligjore ne zbatim te ketyre ligjeve
- Si dhe mbeshtetur ne Rregulloren e Brendshme te Bashkise Malesi e Madhe .

Administratori I Njesise administrative Kelmend z.Adriatik Çekaj

Njësia administrative Kelmend është pjesë e struktures së Bashkisë Malësi e Madhe Me një Administrator dhe 12 punonjes

U konstatuan mangesi të gjithanshme .

- 1.Nuk është krijuar regjistri i subjekteve private të regjistruar në Sektorin e Tatim Taksave.
2. Nuk hartohet plan mujor dhe vjetor për kontrollin e subjekteve.
3. Nuk është realizuar detyra e arketimit të debitoreve pasi janë bërë vetem njoftimet për detyrimet.
- 4.Nuk jane zbatuar tarifat e përcaktuara në paketen fiskale .Ka diferenca tek taksa e pastrimit me 900 leke,**
- 5.Eshtë bërë planifikimi i taksave dhe i tarifave në paketen fiskale i detajuar sipas llojeve të taksave dhe tarifave.
- 6.Ushtrijne aktivitetin bizneset e vogla por nuk janë të licensuara.
- 7.Nuk është krijuar regjistri për të gjitha subjektet me detajimet e nevojshme per secilen nga llojet e taksave dhe tarifave.
- 8.Nuk jane te plotesuara kartelat analitike.
9. Nuk behen kontrole dhe inspektime per te gjitha subjektet ne terren, per subjektet qe nuk shlyen detyrimet vendore nuk lene procesverbale deri ne mbyllje te aktivitetit ne rast mosshlyerje te detyrimeve.
10. Nuk behen rakordimet me Degen e Finances per te gjitha arketimet dhe te detajuara sipas llojit te taksave.
- 11.Nuk jane derguar Urdher bllokime te llogarive bankare ne te gjitha Bankat ekzistuese per subjektet private te cilat kane detyrime te palikujduara per vite me radhe dhe ushtrojne aktivitet privat .
- 13.Mungon dokumentaconi i nevojshem ne dosjet e subjekteve, nder te tjera mungon edhe plan vendosja e objekteve te ketyre subjekteve.
- 14.Administratori i njesise administrative kelmend, nukpermbush detyrat funksionale qe jane te caktuara ne **ligjin Nr. 139/2015 PËR VETËQEVERISJEN VENDORE dhe Rregulloren e Bashkis Malesi e Madhe**
15. Nuk harton plane pune mujore nuk jep informacion me shkrim për ndjekjen e objektivave.
- 16.Shkresat e ardhura janë të protokolluara por nuk mund të vërtetohet nëse këto shkresa kanë shkuar në vendin e duhur per zbatimin e tyre
- 17..Shkresat nuk janë të cikluara nga administratori për personin që duhet ta ndjekë.
- 18.Dokumentat e arkës nuk janë të sistemuara nuk janë të lidhura .
19. Mandat arketimet kanë bashkangjitur dokumentat justifikues me perjashtim të vertetimeve t ë cilat nuk I bashkangjiten mandate arketimeve .
- 20.Ne librin e arkës nuk pasqyrohet shuma e mbartur nga një flete në tjetrën ,nuk pasqyron lëvizjen e arkës
- 21.Nuk respektohet gjendja e arkës.

REKOMANDIME.

Nga konkluzionet e arritura mbi gjetjet në këtë auditim me qëllim përmirësimin e punës rekomandojme :

- 1- Të krijohet regjistri i subjekteve private dhe të pasqyrohet lista debitoare
- 2- Të realizohet detyra e arketimit të debitorëve.
- 1- Të arketohen detyrimet e trashëguara nga vitet e mëparshme.
- 2- Të bëhet bllokimi i subjekteve të palicensuara që vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet në territorin e njësisë .
- 3- Të bëhet sistemimimi i dokumentave të arkës.
- 4- Të arketohet diferenca prej 900 lekësh e taksës së pastrimit të marrë më pak nga familjaret.
- 5- Të hartohen plane pune mujore, Te cikloje shkresat e ardhura dhe të përcaktoje personin për ndjekjen e tyre.

Afati I zbatimit gjate gjithë vitit

- 4- Angazhim auditimi . **SEKTORIT TE ASETERVE PRANE BASHKISE MALESI E MADHE**

Baza ligjore ;Në ligjin nr.114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”

Ne ligjin nr 9720 dt 23.04.2007,Per auditin e brenshem ne sektorin public.

Në rregulloren e mbrenshme të Bashkiës të miratuar me vendim nr 1739 dt 04.07 2016. Neni 52 ku pershkruhen prgegjesitë e sektorit të aseteve.

Në udhëzimin nr 30dt 27.12.2011 Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik,

Në ligjin nr 10296 dt 08.07.2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, I ndryshuar

KONKLUZIONET

Rezulton një bashkëpunim jo i mire ndërmjet sektorit të financës dhe atij të aseteve ,kontrolli i brendshëm i këtij sektori nuk funksionon si duhet , Që në momentin e marrjes në dorëzim të aseteve duket qartë se procesverbali ka qënë fiktiv kjo për arsye se nuk janë të pasqyruar mangësitë dhe diferencat që rezultojnë të pasqyruar në regjistrin e aseteve .Identifikimi i këtyre diferencave është bërë nga specialistja e aseteve por nuk është vazhduar më tej.

Problemi I banesave sociale që janë dhënë me qëra Bashkisë Malësi e Madhe akoma nuk ka marre zgjidhje Për zgjedhjen e këtij problemi Zyra e Aseteve ka bashkëpunuar me Zyrën e

Shërbimeve Sociale duke e pajisur më të gjithë dokumentacionin që ka në disponim .Megjithë këtë bashkëpunim ky problem akoma nuk ka marrë një zgjidhje .

Ne te gjithë njesite Administrative verehen mosrakordime ndermjet ndertesave qe I perkasin qendrave shendetesore , zyres arsimore me bilancin 2015. Nuk duhet të

mjaftohemi me konstatimin e diferencave ,por duhet të kërkohet të gjendet një zgjidhje e tyre

Spektori I aseteve ka punuar per krijimin e ketij regjistri ne te cilen pasqyrohen asetet e bashkise .Duke qene se eshte nje sektor I krijuar I ri ka pasur veshtiresi ne mbledhjen e dokumentacionit dhe perditesimin e tij.Inventari paraprak I trasheguar nga ish komunat dhe bashkite ka sjelle problematika që kanë ndikuar në plotësimin e këtij regjistri sidomos tek regjistrimi I pronave.I cili ka nevojë per shume pune per plotesimin e tij

REKOMANDIMET ;

Nga konkluzionet e arritura mbi gjetjet ne kete auditim me qellim permiresimin e punes rekomandojme :

Zyra e aseteve te bashkepunojë me Zyren e finances per sistemimin e diferencave te konstatuar gjate inventarit te marrjes ne dorezim me bilancin e vitit 2015.

Të sistemohet llogaria 211. Pyje dhe kullota më shumë 2606991 lekë.shume e cila I përket Njesisë Administrative Kelmend .

Spektori i aseteve te informojë Njesine Administrative Kelmend per mangesite e konstatuar ne llogarinë 215 Mjete transporti .Te paraqese dokumentat justifikues qe te realizohet justifikimi I tyre.Fugon me vlere 100000 leke me nr 11 te regjistrin

Fadrome me vlere 2850000 leke me nr 12 te regjistrin

Të punohet per llogaritjen e vleres se amortizimit per te gjithë asetet qe nuk ju eshte bere perlllogaritja e tyre .Kjo te realizohet ne bashkepunim me zyren e finances.

Të punohet për vendosjen e dates së daljes në perdorim të asetet qe I perkasin llogarisë 213 Inventari rrugë .rrjete vepra ujore per Bashkinë dhe njesitë vartese atje ku nuk është vendosur, kjo duke ju referuar regjistrin të aseteve. Për zgjidhjen e ketij problemi duhet te bashkepunoni me sektorin e financës.

Të bashkëpunohet me zyren e financës , Zyren Arsimore dhe Shëndetësore për sistemimin e diferencave të konstatuara tek inventari I shkollave dhe qendrave shëndetësore.

Të bashkepunoni me Zyren e Sherbimeve Sociale për problemin e dhënies me qera te apartamenteve qe jane prone e bashkise.

Të vazhdohet te punohet per regjistrimin e pronave te bashkise te cilat identifikohen të pa regjistruar.

Të evidentohen të gjitha asete që janë jashtë përdorimit dhe të merren masat për nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre

5- PROGRAMI I ANGAZHIMIT TË AUDITIMIT PER VLERESIMIN E AKTIVITETIT TE NJESISE ADMINISTRATIVE KASTRAT.

Nëjsia administrative Kastrat është pjesë e strukturës së Bashkisë Malesi e Madhe
Struktura e Njësisë administrative Kastrat për periudhen 01.01.2016-31.12.2016 është e përbërë nga

1.Administratori. **Miljan Gjeka** 2.Specialist Finance Protokoll3.Inspektor Tatim Taksave 2 punonje4.Llogaritare Arketare5.Specialist Pyjesh6.Specialist veterinare7.Punonjes sherbimi8.Specialist i ndihmesekonomike9.Specialist Bujqesie.10.Sp sherbimeve publike.11.Punonjes sherbimesh 2

Qëllimi i Auditimit : Verifikimi i realizimit të detyrave funksionale në përputhje me ligjin dhe Rregulloren e Brendshme të Bashkisë .

Të ndihmojë në realizimin e objektivave të veprimtarisë duke përmirësuar sistemet e kontrollit .

Lloji i Auditimit : financiar dhe performances

Metoda e Auditimit : i plotë

Baza ligjore .

- Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”
- Ligji nr.9632 date 30/10/2006 ‘Per Sistemin e Taksave Vendore’i ndryshuar.
- Ligji nr. 10296 date 08/07./2010’’Per menaxhimin financiar dhe kontrollin’’ i ndryshuar
- Si dhe akte te tjera nenligjore ne zbatim te ketyre ligjeve

Si dhe mbështetur ne Rregulloren e Brendshme te Bashkise Malesi e Madhe

KONKLUZIONE

Nga auditimi rezulton se:

Administrator i njësisë administrative Kastrat

Harton plane pune mujore jep informacion me shkrim për ndjekjen e objektivave.

-Shkresat e ardhura janë të protokolluara dhe vërtetohet nëse këto shkresa kanë shkuar në vendin e duhur për zbatimin e tyre.

-Shkresat nuk janë ët cikluara nga administratori për personin që duhet ta ndjeke.

Egziston nje korrespondence e rregullt midis kerkesave dhe ankesave të banoreve me administratorin dhe me Bashkinë Malësi e Madhe.

Shton problemet e ngritura dhe bën ndjekjen më tej,

Ndjek urdhrat e miratuar nga Kryetari i Bashkisë.

Nuk ka marrë masa e duhara ligjore për të arkëtuar detyrimet fiskale që rrjedhin nga paketa fiskale.

Libri i arkës është mbajtur konform ligjeve të kontabilitetit

Jane plotësuar si duhet rubrikat që përmban libri i arkës.

Rakordon shuma e librit te arkes me shumen e fatures per arketim,

Nuk përmbushet detyra funksionale e përcaktuar në rregulloren e Bashkisë neni 50 pika 5 në lidhje me respektimin e gjendjes së arkës.

Libri i arkës firmoset nga arkëtari .

Dokumentacioni i arkës është i lidhur

Në librin e arkës pasqyrohet shuma e mbartur nga një flete në tjetren , pasqyrohen levizjet e arkes

Eshtë krijuar regjistri i subjekteve private të regjistruar në Sektorin e Tatim Taksave.

Nuk hartohet plan mujor dhe vjetor për kontrollin e subjekteve.

Nuk është realizuar detyra e arkëtimit të debitorëve familjare .

Disponon regjister analitik per debitorët familjare

Eshte krijuar dhe zbatohet struktura per administrimin dhe mbledhjen e taksave sipas miratimit te struktures ne fillim te vitit.

Jane zbatuar tarifat e percaktuara ne paketen fiskale .

Eshte bere planifikimi i taksave dhe i tarifave ne paketen fiskale i detajuar sipas llojeve te taksave dhe tarifave.

Plotëson dosjet personale të subjekteve me të gjitha të dhënat.

Eshte krijuar regjistri per te gjitha subjektet me detajimet e nevojshme per secilen nga llojet e taksave dhe tarifave

Ushtron kontrolle dhe inspektime per te gjitha subjektet ne terren, per subjektet qe nuk shlyen detyrimet vendore jane lene procesverbale deri ne mbyllje te aktivitetit ne rast mosshlyerje te detyrimeve.

Behen rakordimet me Degen e Finances per te gjitha arketimet dhe te detajuara sipas llojit te taksave.

Nuk jane derguar Urdher bllokime te llogarive bankare ne te gjitha Bankat ekzistuese per subjektet private te cilat kane detyrime te palikujduara per vitet 2016 dhe qe vazhdojne te ushtrojne aktivitet privat .

Zbatohet tarifat per biznesin e madh sipas paketes fiskale te miratuar me vendimin e Keshillit Bashkiak .

Ne dosjet e sybjekteve qe ushtrojne aktivitet tregtim karkuranti nuk disponojne faturen per shlyerjen e detyrim per ushtimin e aktivitetit.

REKOMONDIMET

Nga konkluzionet e arritura mbi gjetjet ne kete auditim me qellim permiresimin e punes rekomandojme :

- 1.Te realizohet detyra e arketimit te debitoreve te trashiguar nga vitet e mepashme si familjare ashtu dhe bizneset.
- 2.Te behet bllokimi i subjekteve debitore qe vazhdojne te ushtrojne aktivitet ne territorin e njesise pa shlyer deturimin per ushtimin e aktivitetit.
- 3.Te hartohen plane pune mujore,Te cikloje shkresat e ardhura dhe te percaktoje personin pergjegjes per ndjekjen e tyre.
- 4.Te respektohet limiti i gjenjes se arkes.si dhe te mbahet nje kopje e te gjitha vertetimeve te leshuar nga njesia ne mandat arketimet e arkes

6- PROGRAMI I ANGAZHIMIT TË AUDITIMIT PER VLERESIMIN E AKTIVITETIT TE NJESISE ADMINISTRATIVE QENDER. Administrator z. Bashkim Cubaj.

Baza ligjore .

- Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”
- Ligji nr.9632 date 30/10/2006 ‘Per Sistemin e Taksave Vendore’i ndryshuar.
- Ligji nr. 10296 date 08/07./2010’’Per menaxhimin financiar dhe kontrollin’’ i ndryshuar

- Si dhe akte te tjera nenligjore ne zbatim te ketyre ligjeve

Njesia administrative Qender eshte pjese e struktures se Bashkise Malesi e Madhe Struktura e Njesise administrative Qender per periudhen 01.01.2016-31.12.2016 eshte e perbere

1.Adminiator2.Specialist Finance Protokoll3.Inspektor Tatim
Taksave.4Arketar.5.Zooveteriner.6.Roje.7.Specialist Mjedisi..8.Specialist i ndihmes
ekonomike.9.Specialist Bujqesie.10.Sp sherbimeve publike.

KONKLUSIONE

Nga auditimi rezulton se:

Administrator i njesise administrative **Qender** .

-Nuk harton plane pune mujore nuk jep informacion me shkrim per ndjekjen e objektivave.

-Shkresat e ardhura jane te protokolluara por nuk mund te vertetohet nese keto shkresa kane shkuar ne vendin e duhur per zbatimin e tyre.

-Shkresat nuk jane te cikluara nga administratori per personin qe duhet ta ndjeke.

Egziston nje korrespondence e rregullt midis kerkesave dhe ankesave te banoreve me administratorin dhe me Bashkine Malsi e Madhe.

-Shtron problemet e ngritura por nuk ben ndjekjen me tej,

-Ndjek urdhrat e miratuar nga Kryetari i bashkise.

-Nuk ka marre masa e duhara ligjore per te arketuar detyrimet fiskale qe rrjedhin nga paketa fiskale.

-Llibri i arkës nuk eshte mbajtur konform ligjeve te kontabilitetit.

- Nuk jane plotesuar si duhet rubrikat qe permban libri i arkës.

-Ne disa raste kemi nje numer te njejte per disa mandate arketime.

-Ne dy muaj nuk rakordon shuma e librit te arkës me shumen e fatures per arketim,

-Nuk permbushet detyra funksionale e percaktuar ne rregulloren e Bashkise neni 50 pika 5 ne lidhje me respektimin e gjenjes se arkës.

- Ne shumicen e rasteve derdhjet behen njehere ne muaj.

-Libri i arkës nuk firmoset nga arketari me perjashtim të katër muajve.

-Dokumentacioni i arkës nuk është i lidhur.

.-Në librin e arkës nuk pasqyrohet shuma e mbartur nga një fletë në tetë ,nuk pasqyrohen levizjet e arkës .

- Është krijuar regjistri i subjekteve private të regjistruar në Sektorin e Tatimit Taksave.

- Nuk hartohet plan mujor dhe vjetor për kontrollin e subjekteve.

-Nuk është realizuar detyra e arkëtimit të debitorëve familjare .

-Nuk disponon regjister analitik për debitoret familjare.

Është krijuar dhe zbatohet struktura për administrimin dhe mbledhjen e taksave sipas miratimit të strukturës në fillim të vitit.

Jane zbatuar tarifatat e përcaktuara në paketën fiskale .

Është bërë planifikimi i taksave dhe i tarifave në paketën fiskale i detajuar sipas llojeve të taksave dhe tarifave.

Është krijuar regjistri për të gjitha subjektet me detajimet e nevojshme për secilin nga llojet e taksave dhe tarifave.

Nga kontrollet dhe inspektimet për të gjitha subjektet në terren, për subjektet që nuk shlyen detyrimet vendore nuk janë lënë procesverbale deri në mbyllje të aktivitetit në rast mosshlyerje të detyrimeve.

Behen rakordimet me Degen e Finances për të gjitha arketimet dhe të detajuara sipas llojit të taksave.

Nuk janë dërguar Urdhër bllokime të llogarive bankare në të gjitha Bankat ekzistuese për dy subjektet private të cilat kanë detyrime të palikujduara për vitet 2016 dhe që vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet privat .

Zbatohet tarifatat për biznesin e madh sipas paketës fiskale të miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak .

REKOMANDIMENnga konkluzionet e arritura mbi gjetjet në këtë auditim me qëllim përmirësimin e punës rekomandojmë :

1- Të krijohej regjistri i tatimpagueve familjare .dhe të pasqyrohej lista debitorë

2- . Të realizohet detyra e arkëtimit të debitorëve.

- 1- Të arketohen detyrimet e trashëguara nga vitet e mëparshme.
- 2- Të bëhet bllokimi i subjekteve debitore që vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet në territorin e njesisë .
- 3- Të bëhet sistemimi i dokumentave të arkës. Funksionimi i arkës të bëhet duke u bazuar në ligjin e kontabilitetit.
- 4- Të hartohen plane pune mujore, të cilat shprehin detyrimet e ardhura dhe të përcaktojnë personin përgjegjës për ndjekjen e tyre.
- 5- Të bëhet verifikimi në terren i të gjithë vetdeklarimeve të paraqitura nga tatimpaguesit familjare nga ana e specialistit të bujqësisë në bashkëpunim me inspektorin e taksave.

Angazhim auditimi në dhënjen e konsulencës duhur ligjore. Sektorit të tatimit taksave në Bashkinë Malesi e Madhe miratuar me nr prot 4118/2 prot Koplík 03.10.2017 nga kryetari I Bashkisë Malesi e Madhe për periudhën tetor – Nëntor 2017

Angazhim konsulence për zbatimin e detyrave të lëna nga klsh sipas rekomandimeve. Kemi ndjekur dhe kemi kërkuar zbatimin e detyrave dhe rekomandimeve të lëna nga K.L.SH. Angazhimi I konsulencës është bërë prezente zv/kryetarit të bashkisë z.Sytki Ndrecaj për të gjitha rekomendimet që janë shënuar në raportin e K.L.SH

VIII. Konkluzione

Auditi I Brendshëm do të punojë për të rritur cilësinë dhe dobishmërinë, të drejtorive, sektoreve dhe njësive vartëse në arritjen e qëllimeve dhe objektivave duke përmirësuar sistemet dhe shërbimet e njësive.

Specialisti i auditimit të brendshëm

Tonin Toma

Auditues; Shpresa Salihaj

Auditues; Aida Haxhija

Nr. Kopjove. 5 (pese)